



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 278 prot.

Tiranë, më 15.02.2019

**VENDIM**

Nr. 8, datë 15/02/2019

**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË  
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË BASHKINË TROPOJË DHE  
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E  
LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Tropojë,

**KONSTATOVA SE:**

Me vendimin nr. 64, datë 07.06.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Tropojë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Bashkia Tropojë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si menaxherë në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 506/1 prot., datë 07.06.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 506/2 prot., datë 07.06.2018, “*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Tropojë*”, i është njoftuar Bashkisë Tropojë.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 506/3, datë 04.12.2018, “*Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në Bashkinë Tropojë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, duke i lënë një afat **15** ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresën nr. 2718/2 prot., datë 04.12.2018, “*Observacione mbi projektraportin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dërguar me shkresën nr. 506/3 prot., datë 21.11.2018*”, është shprehur dakord në përgjithësi për konkluzionet e nxjerra nga grupi i punës dhe ka pasqyruar disa sqarime dhe sugjerime në lidhje me gjetjet në projektraport, të cilat janë trajtuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar, në kapitujt përkatës.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i mbikëqyrjes, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”,

si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### VENDOSA:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Tropojë dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Me qëllim realizimin e një strukture organizative të qëndrueshme, për vitin 2019, e në vijim, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe duke respektuar kompetencat ligjore të përcaktuara në ligjin për vetëqeverisjen vendore, gjatë procesit të hartimit të strukturës së bashkisë, njësia përgjegjëse e institucionit duhet të veprojë duke ndjekur këtë radhë pune:
  - Gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucionit për vitin në vijim, të zbatohet skema e funksionimit të shërbimit civil, në përputhje me nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të sigurohet aplikimi i të gjitha instituteve të ligjit, duke u orientuar në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, në rubrikën që i përket këtij aspekti.
  - Për pozicionet e punës me emërtesën “Administrator i ndihmës ekonomike”, “Administrator për paaftësinë dhe invaliditetin”, “Punonjës social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” dhe “Punonjës i arkivit dhe protokollit”, pjesë e organikës së administratës së bashkisë, njësia përgjegjëse të saktësojë emërtesat sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
  - Për pozicionet me emërtesën “Punonjës i ndihmës ekonomike”, “Specialist i bujqësisë dhe shërbimeve”, “Inspektor i shërbimit pyjor dhe sekretar/arkivit” dhe “Inspektor i shërbimit të pyjeve dhe kullotave”, pjesë e organikës së njësive administrative, duhet të përcaktojë qartësisht detyrat teknike dhe përgjegjësitë që realizon secili pozicion pune dhe më pas, të përcaktojë nëse këto pozicione përfshihen në skemën e shërbimit civil, apo janë funksione ndihmëse administrative, duke rregulluar njëkohësisht edhe emërtimin e këtyre pozicioneve, në varësi me qëndrimin që do të mbahet në drejtim të raportit të tyre me shërbimin civil.
  - Pozicionet e punës, pjesë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, të përfshihen në shërbimin civil, duke përcaktuar qartësisht detyrat dhe funksionet e tyre, si dhe

t'i plotësojë këto pozicione, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 22, 23, 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

- Ndryshimet e mësipërme, duhet të evidentohen në rregulloren e brendshme të institucionit, e cila aktualisht në përmbajtje të saj, nuk përcakton qartësisht se për cilat pozicione pune marrëdhënia e punësimit rregullohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
3. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të marrë masa që përshkrimet e punës të hartuara sipas formatit standard të miratohen nga drejtuesi i institucionit dhe më pas të nënshkruhen nga nëpunësi civil që punon në pozicionin për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, si dhe drejtori i drejtorisë përkatëse, i cili paraqitet në cilësinë e eprorit direkt.

Për pozicionet e punës, të cilat nuk janë përfshirë në skemën e shërbimit civil, njësia përgjegjëse duhet të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu si përcaktohet në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, lidhjen 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në udhëzimin nr. 2, datë 07.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".

4. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Bashkinë Tropojë, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në rastin e punonjësës \*\*\*\*\*, e cila është deklaruar me statusin e punësimit: "Nëpunës civil", në pozicionin e punës "Përgjegjës i Zyrës së Ndihmës Ekonomike", në ish komunën Bujan, në kundërshtim me ligjin, duhet të kryejë veprimet si më poshtë:

- Të ndryshojë aktin administrativ nr. 114/1 prot., datë 29.04.2015, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen \*\*\*\*\*, duke e ndryshuar pozicionin e saj në raport me shërbimin civil, nga "nëpunës civil", në "nëpunës civil në periudhë prove", për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.
- Njësia përgjegjëse në këtë rast, duhet të marrë masa që nëpunësja në fjalë t'i nënshtrohet ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

- Eprori direkt, të nxjerrë për nëpunësen vendimin e arsyetuar të konfirmimit ose jo, në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës dhe plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).
5. Njësia përgjegjëse të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësin \*\*\*\*\*, emëruar aktualisht në pozicionin “*Specialist për zhvillimin e territorit*”, duke evidentuar faktin se ky punonjës, nuk plotëson kriterin arsimor për të qenë nëpunës civil, pasi nuk zotëron diplomë të arsimit të lartë.
- Pozicioni i punës të shpallet i lirë, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.
6. Njësia përgjegjëse të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 26/4 prot., datë 26.04.2015, nëpërmjet të cilit është deklaruar si nëpunës civil punonjësi \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i zyrës së Ujësjellësisë*”, si akt që ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi ky pozicion nuk përfshihet në shërbimin civil.
7. Kryetari i Bashkisë Tropojë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat, duke vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit dhe asaj financiare me institucionin, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit, të nxjerra nga titullari i institucionit:
1. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist për topografinë*”, në Sektorin e Pronave dhe Haartografisë, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me urdhrin nr. 33, datë 24.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
  2. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i burimeve njerëzore*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, me urdhrin nr. 46, datë 15.03.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
  3. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i emergjencave civile*”, në Sektorin e Emergjencave Civile dhe Transportit, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse, me urdhrin nr. 1, datë 11.01.2016.
  4. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i bujqësisë dhe shërbimeve*”, me urdhrin nr. 1587 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;

5. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, me urdhrin nr. 1084/2, dat 01.06.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
  6. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i shërbimit pyjor dhe sekretari/arkiv*”, me urdhrin nr. 1190/1 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
  7. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, me kontratën e datës 03.01.2015;
  8. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i shërbimit të pyjeve dhe kullotave*”, me urdhrin nr. 2098/1 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
  9. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike dhe sekretar/arkivit*”, me urdhrin nr. 37, datë 18.03.2016;
  10. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i bujqësisë*”, me urdhrin nr. 112, datë 15.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë.
  11. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike dhe sekretar/arkivit*”, me urdhrin nr. 1596 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
  12. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, me urdhrin nr. 2466/1 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
  13. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike dhe mbajtës i dokumentacionit të bujqësisë*”, me urdhrin nr. 2457/1, datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
  14. \*\*\*\*\*, emëruar “*Përgjegjës Sektori*”, me vendimin nr. 71, datë 26.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
  15. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i pyjeve dhe kullotave*”, me vendimin nr. 47, datë 31.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
  16. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i pyjeve*”, me vendimin nr. 96, datë 27.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
  17. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inxhinier pyjesh*”, me vendimin nr. 26, datë 26.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
8. Për të rregulluar ligjshmërinë e procesit të ristrukturimit në institucionin Bashkia Tropojë, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse dhe Komisioni i Ristrukturimit, në kuptim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duhet të marrin masat si më poshtë:
- Njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 18, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, si dhe nenit 144, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, duhet të kërkojë ndaj Komisionit të Ristrukturimit rishikimin dhe ndryshimin e aktit nr. 4547/1 prot., datë 29.01.2018, “*Relacion për transferimin e nëpunësve civilë në kuadrin e ristrukturimit*”;

- Komisioni i Ristrukturimit, duhet të ndryshojë aktin nr. 4547/1 prot., datë 29.01.2018, “*Relacion për transferimin e nëpunësve civilë në kuadrin e ristrukturimit*”, duke shqyrtuar mundësinë e transferimit për nëpunësit  
 \*\*\*\*\*  
 \*\*\*\*\*  
 \*\*\*\*\*  
 \*\*\*\*\*  
 \*\*\*\*\*  
 \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*  
 pozicionet e të cilëve janë prekur si pasojë e ristrukturimit, ose kanë ndryshuar emërtesën e njësisë ku ato raportojnë.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit, Komisioni i Ristrukturimit, duhet të propozojë transferimin e tyre, në pozicionet e punës ku ata faktikisht kanë ushtruar detyrën në përfundim të procedurës së ristrukturimit (datë 31.01.2018).

- Njësia përgjegjëse, duhet të finalizojë këtë proces me nxjerrjen e akteve individuale të transferimit të përhershëm për çdo nëpunës civil, duke evidentuar saktësisht në këtë akt emërtesën e pozicionit, si dhe emërtesën e njësisë organizative pjesë e të cilës janë (sektori ose/dhe drejtori), ku këta nëpunës janë transferuar në përfundim të këtij procesi (datë 31.01.2018);
- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, duhet të plotësojë dosjen e personelit me aktin e mendimit me shkrim të punonjësve, që janë riemëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ku shprehet pëlqimi i tyre në lidhje me këtë transferim.

9. Njësia e burimeve njerëzore në institucion, të sistemojë dosjen e personelit për çdo nëpunës civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet e konstatuara në mungesë në tabelat që janë anekse të raportit të mbikëqyrjes , si dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 dhe 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.

10. Për kryerjen e këtyre veprimeve, lihet afat **3 muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe të bashkëpunojnë me Komisionerin në drejtim të mbështetjes me asistencë teknike gjatë kësaj periudhe më qëllim realizimin brenda afatit të detyrave të lëna në vendimin paralajmërues.

11. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Tropojë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

12. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
13. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Tropojë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Ministria e Brendshme dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**